



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Nr. 02/ 694

Datë: 17.12.2019.

Procesverbal

I mbledhjes së II dytë urgjente të kuvendit komunal në Malishevë.

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i situatës së krijuar pas fatkeqësisë natyrore- tërmetit në Republikën e Shqipërisë.
2. Vendimi për formimin e shtabit koordinues për menaxhimin, grumbullimin dhe transportimin e ndihmave për qytetarët e prekur me rastin e fatkeqësisë natyrore-tërmetit në Republikën e Shqipërisë.
3. Vendimi për ndarjen e mjeteve në shumë prej 5.000 (pesëmijë) euro nga buxheti i Komunës së Malishevës, si ndihmë për zonat e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore-tërmeti në Republikën e Shqipërisë.

Mbledhja u mbajt me datë: 27.11.2019, filloj ne orën: 10:00 minuta.

- Të pranishëm ishin 25 (njëzet e pesë) anëtarë të asamblesë Kryetari, Nënkryetari, Kryesuesi, drejtorët si dhe përfaqësuesi i OSB-së.

- **Rrahim Morina.**- I nderuar kryetar i komunës të nderuar asamblistë dhe qeveri komunale. Me rastin e fatkeqësisë natyrore në Shqipëri i cili ka shkakto mbi 24 viktima në shenjë nderimi dhe respekti për viktimat ju ftoj për një minutë heshtje. Sot jemi tubuar të solidarizohemi dhe të ju dalim në ndihmë motrave dhe vëllezërve tonë në këto ditë të rënda të kombit tonë dhe të gjithë të jemi pran familjeve pranë popullit të Shqipërisë, i cili në ditët më të vështira gjatë luftës na strehoj dhe na ndihmoj na përkrahi vazhdimisht. Andaj edhe ne do të jemi në dispozicion të tyre për ti ndihmuar popullin e Shqipërisë në të gjitha aspektet edhe ne si kuvend komunal si komunë e Malishevës do të qëndrojmë pranë familjeve dhe personave të lënduar në këtë fatkeqësi natyrore që ndodhi këtyre ditëve në Shqipëri. Urojna që të mos vazhdoj përsëri tërmeti dhe viktima të ketë sa ma pak, familjeve të tyre gjithashtu ju shprehi ngushëllime të sinqerta ndërsa të lënduarve ju urojna shërim sa ma të shpejtë. Ftoj edhe kryetarin e komunës për një fjalë rasti.

- **Ragip Begaj.**- I nderuar kryesues, të nderuar asamblistë ju pjesë e qeverisë që jeni këtu. Natyrisht që jemi të gjithë të prekur edhe unë bashkë me juve gjithashtu dhe të gjithë qytetarët e komunës së Malishevës ndien bashkë dhimbje me ngjarjen që ka ndodhur ne Shqipëri jemi solidar dhe jemi të solidarizuar me dhimbjen e tyre dhe jemi pjesë e dhimbjes së tyre. E kemi obligim për këto raste se kudo që jemi të jemi bashkë me ta. Na i shprehim ngushëllime të sinqerta të gjitha familjeve në emër timin dhe në emër të komunës së Malishevës do të jemi së bashku me ta me mundësit e tona të cilat i

kemi edhe do të jemi të angazhuar në maksimum, se pak a shumë të ju kthejmë ndihmën që na kanë dhanë. Por me gjithë atë ju kemi borxh kudo që ndodhin këto gjëra mu kanë solidar dhe bashkëpunëtor me ta edhe me kanë bashkdhimbës me ta. Jemi një gjak jemi një komb. Çdo gjë që na ka godit na ka godit të gjithë neve edhe kudo në trojet shqiptare çka do që ndodhë është goditje për të gjithë neve por besoj që do ta tejkalojnë familjet. Ka ndodh një raste që thojnë prej zotit dhe nuk ka kush që mund ti ndaloj këto gjëra, por mundet mu kanë pjesë e dhimbjes tyre. Në emër timin dhe në emër të gjithë juve të gjithë qytetarëve ju përcjelli ngushëllimet e sinqerta atyre inshalla zoti i shpërblen me xhenet të gjithë ata të ranë.

- **Rrahim Morina.**- Unë mendoj që isha leshu vetëm në shefat e grupeve dhe ti nxjerrim disa vendime si kuvend komunal, fillojna nga nisma.

- **Arbreshë Krasniqi.**- Faleminderit kryetar përshëndetje kryesues, përshëndetje kryetar koleg asamblistë, drejtor të pranishëm. Ne si grup parlamentar i Nismës Socialdemokrate ne Malishevë ndjejmë së bashku dhimbjen në fatkeqësinë që ndodhi në Shqipëri kështu që të gjitha këto humbje janë pjesë e humbjes edhe tek ne. Kemi përcjell me dhimbje por mbi të gjitha janë këto çështje të natyrës të cilat ndodhin dhe nuk mund të drejtohen nga ana e jonë. Por nga ana jonë tregohet solidariteti, tregohet bashkë ndjenja, tregohet dhimbja që kemi pasur me ta dhe sigurisht që në të gjitha instancat dhe mundësitë që ne i kemi do te tregojmë një përkushtim ndaj solidaritetit dhe mundësisë për popullin shqiptar të Shqipërisë, ne si grup parlamentar i nismës në Malishevë besojmë fuqishëm në solidaritetin e popullit të Malishevës dhe lutemi që jo vetëm në përmasa institucionale por në përmasa të popullit të Malishevës që të tregojna gatishmërinë, solidaritetin për ndihma dhe përkrahje në drejtim të lënduarve dhe sigurisht që Malisheva do të dijë ta tregoj edhe këtë gjendje.

- **Alban Mazreku.**- Përshëndetje për të gjithë i nderuar kryetar të nderuar drejtor asamblistë të nderuar qytetar të komunës së Malishevës edhe ne si grup parlamentar i PDK- së bashkë ndjejmë dhimbjen me tërmetin që shkaktoj shumë viktime në shtetin amë në Shqipëri. Me këtë rast në emër të grupit parlamentar i shprehim ngushëllime të gjitha familjeve të viktimave të tërmetit në Shqipëri si dhe familjes Abazi nga Gjilani e cila humbi dy anëtar të familjes së tyre. Në këtë rast ju bëj thirrje edhe qytetarëve të Malishevës se edhe ashtu janë të mobilizuar kështu që bëj thirrje edhe bizneseve të organizohen. Ne paraprakisht u koordinuam me shefat e grupeve që ta bëjnë një komision i cili do të kujdeset për të gjitha vendimet e këtij kuvendi që do të nxirren sot si dhe për pjesëmarrjen e bizneseve që ta ndihmojnë dhe të jemi sa ma afër shtetit shqiptar në këto ditë të rënda për ta faleminderit.

- **Valon Krasniqi.**- Përshëndetje për të gjithë drejtorët, kryesuesin, kryetarin dhe ju të gjithë te pranishmit në këtë seancë të jashtëzakonshme solidarizuese mbështetëse me të vetmin qëllim, me të vetmen lutje, me të vetmen dëshirë, më të vetmen dhimbje, me të vetmin ngushëllim, me të vetmin vullnet dhe gatishmëri mobilizuese për kombin, vëllezërit dhe motrat tona. Të nderuar qytetarë Shqipëria dhe shqiptarët po përjetojnë një tragjedi të rëndë nga pasojat e tërmetit. Pra sot secili nga ne fizikisht ndodhemi këtu por me mendje e me zemër jemi tekë Durrësi, Kurbini e Thumana, ku si pasoj e kësaj fatkeqësie në shoqërinë tonë, në Shqipërinë tonë ishte e shkruar që të humbin jetën dhjetëra vëllezër dhe motra tona dhe qindra të lënduar, ku shprehim ngushëllimet më të sinqerta në

emër të grupit tonë parlamentar, shprehim ngushëllimet më të sinqerta familjarëve të viktimave të tërmetit që goditi Shqipërinë dhe njëkohësisht lutemi për të gjithë vëllezërit dhe motrat tona të prekur nga kjo tragjedi. Të nderuar kolegë dhe ju të pranishëm më lejoni që para jush ti citoj disa vargje të përpiluara nga aktori ynë i çmuar Çun Lajçi vargje të cilat do të na mbushin me motivacion që e mira dhe e keqja, tragjedia dhe festa, gjuha dhe gjaku, vështirësitë dhe dhimbja, solidariteti dhe mbështetja, ngushëllimi dhe gëzimi do të duhej gjithë herë të na përcjellin si komb e sigurisht të mos na dhimbet asgjë nga vetvetja sepse jemi një, jemi vëllezër dhe motra. Po fillojna me vargjet: Shqipnisë time të luhatun kur dridhesh ti ne nuk bëjmë gjumë Shqipni se tutemi po vdes e ndoshta po mbesim jetim, të duem edhe kur vërshohesh ujnash edhe kur digjesh zjarresh edhe kur mallkohesh kur lutesh dridhesh e përkundesh tërmetesh si zogj të futemi ne gji e lutemi vetëm ti të mos vdes. Ne nuk bëjmë gjumë kur ti dridhesh se veç ty të kemi Shqipni.

- **Alban Krasniqi.**- Të nderuar anëtarë të kuvendit komunal, i nderuari kryesues kryetar dhe ju kabinet të qeverisjes lokale. Dhimbja sot na bashkoj të gjithëve pa dallim siç i bashkoj shqiptarët kudo globin dhe nuk kemi se si mos ta ndajmë këtë dhimbje jo vetëm me fjalë por edhe me mobilizim të jashtëzakonshëm i cili po shihet kudo ku ka shqiptarë edhe ku nuk ka shqiptar. Kjo dhimbje tash ka marrë edhe përmasa botërore pa dallim sepse është edhe humane që ti të ndash dhimbjen dhe ti dalësh në ndihme cilit do popull e cilit do grup i cili mund të ndihet i rrezikuar qoftë këtë rast edhe nga fatkeqësitë natyrore. Kjo mbledhje urgjente e cila është thirrur uroj që të nis edhe më shumë mobilizimin tonë si komunitet i Malishevës prej komunës së Malishevës dhe në kuadër të sajë unë i kisha dhënë disa prej rekomandimeve që edhe bashkë i biseduam paraprakisht me anëtarët kolegut tjerë por kanë ardhur edhe si nevoja edhe e kushteve rrethanave si me tani por edhe e një themi interesimi qytetar që dhe Malisheva ndonëse nuk ka mbet mbrapa. Është parë edhe ditën e djeshme dhe sot me iniciativa qytetare në mbledhjen e ndihmave me aq sa qytetarët mujnë që të ju dalin ndihmë motrave dhe vëllezërve tanë në zonat e prekura nga tërmetet që po ndodhin në këto orë dhe këto ditë. Në kuadër të kësaj unë kisha kërku që së pari të krijohet një grup mund të themi edhe shtab koordinues edhe grup koordinues, përbërja e secilit do të ishte përfaqësues edhe të kuvendit komunal dhe të forcave politike këtu që i kemi. Siç e diskutuam edhe me zyrtarët nga drejtoria e emergjencës pse jo edhe kryetari edhe kryesuesi qëllimi i këtij shtabi apo grupi koordinues do të ishte që të gjithë këto iniciativa që po i shohim kudo tek komuniteti ynë këtu në Malishevë tek grupet e ndryshme qytetarësh të mobilizuar që ti mbledhim të gjitha këto iniciativa bashkë ti koordinojnë në mënyrë që të ju dalim edhe këtyre grupeve me mirë edhe të koordinohen për arsye transporti edhe për arsye të një, themi koordinimi edhe me autoritetet shqiptare atje në zonat e prekura në mënyrë që të sigurohemi që ndihmat të shkojnë aty ku ka me së shumti nevojë dhe ne kohen e duhur sa ma shpejt që është e mundur. Në të njëjtën kohë kemi parë që qytetar të shumtë dhe nga Malisheva kanë shprehur gatishmëri që ti hapin dyert e shtëpive gjë për të cilën nuk kam pasur dyshim besoj edhe ju gjithashtu njëjtë dhe do të ishte mirë që ky grup dhe ky shtab ta koordinonte këtë punë sepse tash ma atje jemi futur në sezonin e dimrit afër. Koha është jashtëzakonisht e ftohtë dhe të gjitha ato familje që kanë nevojë të strehohen ky shtab ne koordinim dhe komunikim me të gjithë ata qytetar që kanë shprehë gatishmëri do të mundëson që sa ma parë dhe sa ma shpejt ato familje që kanë nevojë për strehim dhe që dëshirojnë të vinë të mundë të vinë sa ama parë. Tjetra është që sot ora

18(tetëmbëdhjetë) do të ishte më e përshtatshme pasi që edhe me siguri ka edhe profesor këtu tek kompetenca që punojnë edhe të gjimnazi najë një prej jush. Ndoshta ora 6 (gjashtë) është e përshtatshme që të na bashkohen edhe nxënësit edhe arsimtarët edhe qytetarët në të njëjtën kohë të bëjnë një ndezje të qirinjve te sheshi i dëshmorëve në nderim të viktimave në solidarizim dhe ne bashkë ndjenje të asaj se çka ka ndodh se çka po kalon populli shqiptar. Ne ti përket vendimmarrja përfundimtare këtij shtabi që do të themelohet. Si dhe e fundit si propozim është që kjo është tërësisht në baza vullnetare. Unë e di që nevojat për ta tejkaluar këtë gjendje janë shumë më të mëdhaja ato humbje nuk kompensohen dot me asgjë që ne mundë të ofrojmë por ne mund ta bëjmë maksimumin tonë që të tregojna dashamirësi, anën njerëzore tonën vëllazërore tonën dhe në kuadër të kësaj kisha ftu të gjithë asamblastët anëtarët e kuvendit por edhe zyrtarët e lartë në këtë rast drejtorët kryetarin kryesuesin që ti ndajmë nga 50 (pesëdhjetë) euro secili nga paga e jonë aq e vogël sa e marrim. Unë i kuptoj të gjithë por është momenti që të reflektojmë edhe ti ndajmë nga 50 (pesëdhjetë) euro në ndihmë viktimave familjeve sot e kanë gdhi mëngjesin jashtë fëmijë pleq, gra pa dallim. Këto janë ato propozime që edhe i biseduam përveç pjesës tjetër të asaj se do të bënë komuna ne si komunë çfarë fondi do të ndajmë për të cilën ne u dakorduam edhe më parë dhe besoj që kryetari kryesuesi do ta japin pjesën e tyre të kontributit me vendimin që ne si kuvend do të duhej ta nxjerrim.

- **Kastriot Berisha.**- Të nderuar qytetar të komunës së Malishevës, i nderuar kryetar zotëri begaj, kryesues zotëri morina ju koleg asamblast dhe ju drejtor të pranishëm. Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dega në Malishevë përshëndes dhe përkrahi të gjithë këtë solidaritet të cilin e kanë shpreh për vëllezërit tonë në Shqipëri.

- **Rrahim Morina.**- Shkojna në propozime. Ne u konsultuam edhe me kryetarin edhe me shefat e grupeve dhe u dakorduam që ta formojna një shtab koordinues i cili do të merret kryekëput me tragjedinë që ka ndodhur në Shqipëri i cili do të merret me grumbullimin dhe transportimin e të gjitha ndihmave duke përfshi edhe strehimin. Në këtë përbërje sipas marrëveshjes që e patëm do të jetë kryetari, kryesuesi i kuvendit, përfaqësuesit e subjekteve në kuvend por mundësisht të janë shefat, por mundësisht aty ku nuk janë shefat të jenë përfaqësuesit, por kryekëput janë shefat e grupeve. Në pamundësi sot ne të deklarohej dhe ne ta sjellin emrin. Është edhe përfaqësuesi i drejtorisë për shpëtim ne menduam që të jetë Halit Mazreku është edhe propozimi i kryetarit. Drejtoria për ekonomi dhe financa e propozuan që të jetë Valon Mazreku se edhe ka të bëjë me mjetet edhe një përfaqësues i biznesit, nëse ka propozime ose po e lajmë masë andej ose ky komision ne ta merr emrin vetë ne të bisedon me biznese. Propozimi tjetër që të merret përsëri ky komision po e lexoj këtë tani masë andej e hedhim në votim, shuma do të jetë vullnetare 50 (pesëdhjetë) euro kush ka mundësi mund ti afroje nuk është obligative. Shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro le ta zgjedhë përsëri shtabi koordinues ne të mbetet edhe zyra e informimit, pastaj ishte një propozim tjetër e që përsëri do ti mbetet shtabit koordinues në ora 18 (tetëmbëdhjetë) te sheshi i dëshmorëve do të solidarizohemi me fatkeqësinë natyrore në ndezjen e qirinjve. Të gjitha këto organizime i merr shtabi koordinues edhe një herë po e shtojna edhe zyrën e informimit. Faleminderit Artan duhen të sillen edhe të gjitha informacione për të gjitha aktivitetet. I hedhi në votim: Të gjithë për. Nuk ka kundër. Tash e hedhi propozimin tjetër në koordinim me kryetarin dhe shefat e grupeve në shenjë të

solidarizimit. Ne vendosëm si kuvend komunal që ti ndajmë 5 (pesëmijë) euro e që tani përsëri mbetet punë e këtij komisioni për mënyrën se si do të jetë a në formë malli apo në formë mjeteve do të vendosin këta bashkarishtë. Kështu që kuvendi komunal i ndanë 5.000 (pesëmijë) euro për tërmetin që ka ndodhë në Shqipëri. Kush është për, ju lutem me ngritje dore, faleminderit votimi është unanim. Për fund edhe një herë në emër të kuvendit komunal viktimave ju shprehi ngushëllime, ndërsa të lënduarve shërim sa ma të shpejtë dhe urojmë që ky tërmet të ndërprehet sepse kjo ka vazhdu me ditë të tëra dhe mos të ketë viktima tjerë faleminderit. Kryetrari po e kërkon fjalën.


- **Ragip Begaj.**- Po dëshiroj që gjithherë të jemi unik në këtë drejtim edhe jo fatkeqësitë të na bëjnë unik por edhe në gjëra të mira të jemi unik. Unë nuk kam ndonjë biznes personal timin përpos detyrës time që e kam por do të hjekë keq pak nja dy muaj edhe unë do ti ndaj 1000 (njëmijë) euro në vlerë prej pagës time për këtë fatkeqësi që ka ndodh atje. Jam përpjekë gjithherë mu kane në nivel të ndarjes së ndihmave në të gjitha periudhat edhe pse tash nuk e kam atë fuqi që e kamë pasur atëherë, megjithatë ky është vullnet i jemi. Unë si kryetar komune i ndaj 1000 (njëmijë) euro prej pagës time për ndihmë të kësaj fatkeqësie.

- **Rrahim Morina.**- Kryetar faleminderit për humanizëm, ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoj në orën 10/26 minuta.

Procesmbajtësi:

Ilir kryeziu



Kryesuesi i kuvendit

Rrahim Morina

